

13.1 KATALOGIMI NË SHKRIMIN LATIN

Në sistemin COBISS, në shtetet ku përdoret vetëm shkrimi latin, katalogimi bëhet në shkrimin latin. Kjo do të thotë se, të dhënat të cilat në regjistrime janë vendosur në gjuhën e katalogimit (p.sh. shënimet), janë në shkrimin latin, ndërsa të dhënat e tjera mund të jenë edhe në shkrimet e huaja (p.sh. emri i autorit në shkrimin origjinal). Se cilat të dhëna vendosen në shkrimin origjinal dhe cilat transliterohen është kompetencë e qendrave të veçanta kombëtare.

13.1.1 Shënimi i të dhënave

Për shënimin e saktë të të dhënave nevojitet tastierë standarde dhe tastierë me parametrat e duhur të windows-it për gjuhë të veçanta. Në këtë mënyrë mund të vendosen të gjitha shkronjat e gjuhës së veçantë, simbolet e tjera, të cilat janë në tastierë, si dhe simbolet, të cilat futen si shenja të kombinuara dhe shkronja themelore (p.sh. <Alt Gr> + <¨> + <A> shfaqet Å). Në bibliotekat, ku shumica e materialeve janë në gjuhë të huaja, tastiera mund të rregullohet në atë mënyrë që të përkrah edhe gjuhët e tjera. Tastiera e rregulluar në mënyrën e duhur mundëson vendosjen e shumicës së shkronjave përmes tastierës, mirëpo mund të përdorni edhe dritaren **Simbolet COBISS** (shih kap. 7.3.1.1), në të cilën i gjeni simbolet latine që përdoren më së shpeshti.

13.1.2 Kërkimi i të dhënave

Gjatë kërkimit me të dhënat në formë teksti në shkrimin latin mund të përdorni vargun bazë të shkronjave ose shkronjat me shenja diakritike.

Përrjashtim përbën kërkimi me fraza për pikëqasjet në regjistrimet e njësuara CONOR, ku në pyetjen për kërkim duhet patjetër të përdorni shkronjat bashkë me shenjat diakritike.

Për kërkimin e të dhënave të shënuara në shkrimet e huaja, edhe pyetjet për kërkim duhet të shënohet në shkrimet e huaja.